



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M
Nr/169, Datë 25/11/2016

Bazuar në pikën 11¹, të nenit 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

KONSTATON:

Mbështetur në nenin 32, pika 1, germat "a" dhe "c", dhe pika 3 e këtij neni, nenit 33, pika 10 të ligjit nr. 10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka ndjekur të gjithë hapat që parashikon procedura e hetimit, për shqyrtimin e të çështjes së diskriminimit të disa prej kategorive të aftësisë së kufizuar, nga Vendimi i Këshillit të Ministrave të datës 22.07.2015 dhe Udhëzimi nr.29, datë 21.08.2015, i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, lidhur me mosparashikimin e kuotave të pranimit për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuar, por vetëm të kategorisë së personave me aftësi të kufizuar që gëzojnë statusin e të verbërit dhe të paraplegjik/tetraplegjik.

Bazuar në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" në përfundim të procedurës së hetimit, Komisioneri ka dalë me Vendimin nr.179, datë 23.12.2015, në të cilin ka vendosur: *"Konstatimin e diskriminimit të drejtëpërdrejtë, nga ana e Këshillit të Ministrave dhe të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ndaj kategorisë së personave me aftësi të kufizuar, përcaktuar me vendim të KMCAP-së dhe në bazë të Ligjit nr.9355/2005 "Për Ndihmën*

¹ Nëse Komisioneri urdhëron rregullime ose masa, personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit. Në rast se personi, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, Komisioneri vendos masë për ndëshikimin me gjobë për personin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni.



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

Ekonomike dhe Shërbimet Shoqërore”, përveç dy kategorive të përfshira tashmë, të personave të verbër apo paraplegjik/tetraplegjik”.

Në pikën 2 të këtij vendimi Komisioneri ka vendosur: *“Këshilli i Ministrave dhe Ministra e Arsimit dhe Sportit të marrin masa dhe të bëjnë parashikimet e duhura ligjore, për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara, të përcaktuar si të tillë me vendim të KMCAP-së dhe në bazë të Ligjit nr.9355/2005 “Për Ndihmën Ekonomike dhe Shërbimet Shoqërore”, me qëllim garantimin e mundësive të barabarta për të gjithë kategoritë e PAK, në fushën e arsimit; në përzgjedhjen dhe regjistrimin në programet e Ciklit të Parë të Studimeve me Kohë të Plotë, në Programet e Integruara të Ciklit të Dytë në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, si dhe në Programet e studimeve Jouniversitare Profesionale, për vitin akademik 2016-2017”.*

Bazuar në pikën 11, të nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", si dhe në pikën 3, të Vendimit nr.179, datë 23.012.2015, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Këshilli i Ministrave dhe Ministra e Arsimit dhe Sportit, duhet të raportonin brenda 30 ditëve, para Komisionerit për veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi duke informuar Komisionerin për masat e marra.

Për sa më sipër, Komisioneri bazuar në ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ka në tagrin e tij të rekomandojë rregullimet e masat e duhura për të rivendosur në vend të drejtën e mohuar të subjektit ankues, ardhur si pasojë e diskriminimit të konstatuar.

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në nenin 33, pika 10 të tij, përcakton se: *“...Komisioneri shprehet me vendim, i cili u njoftohet palëve brenda 90 ditëve nga dita e marrjes së ankesës ose nëse është zhvilluar një seancë dëgjimore publike, brenda 90 ditëve nga dita e seancës. Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”.*

Komisioneri është shprehur lidhur me shkeljen e dispozitave të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe është në tagrin e tij, të rekomandojë edhe rregullimet përkatëse.

Sa sipërcituar, Komisioneri konstaton se, Ministria e Arsimit dhe Sportit, është në shkelje të pikës 10, të nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", si dhe të



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

parashikimeve të bëra në pikën 11, të nenit 33, të po këtij ligji pasi nuk ka zbatuar vendimin nr.179, datë 23.12.2015 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Me shkresën me nr.931 prot., datë 10.10.2016 i është dërguar sërish një kujtesë MAS, duke e njoftuar që të paraqiste informacion lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e Vendimit të Komisionerit, deri më datë 18.10.2016.

Lidhur me sa më lart, janë tejkaluar afatet e kërkuara për kthimin e përgjigjes.

PËR KËTË ARSYE :

Bazuar në nenin 32, pika 1, germa "ç", nenin 33, pikat 11,12,13/a e 14 të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

VENDOSI:

1. Ministria e Arsimit dhe Sportit, të gjobitet në vlerën 100.000 (një qind mijë) lekë të rinj.
2. Gjoha të derdhet në Buxhetin e Shtetit brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi. Pagesa e kësaj vlere të bëhet pranë çdo banke në llogarinë e thesarit Tiranë, për llogari të: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, NIPT: L02027451K, Kodi: 1091001, Entiteti i Qeverisjes: 1, Distrikti (TDO), Llogaria ekonomike: 7115499.
3. Zbatimi i vendimit nr.179, datë 23.12.2015, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi brenda shtatë ditëve nga marrja dijani për sanksionet, sjell shfuqizimin e tyre.
4. Subjekti, Ministria e Arsimit dhe Sportit, duhet të njoftojë Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi në përputhje me sa parashikohet në pikën 3, të këtij vendimi.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit.



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
 (Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
 Tel: +355 4 2431078
 Fax: +355 4 2431077
 e-mail: info@kmd.al
 web: www.kmd.al